

## Projekti i Nënstacionit të OSHEE-së në Tiranë

**Shteti:** Shqipëri

**Numri i Projektit:** 55982

**Sektori i Biznesit:** Energji, Europë

**Lloji i Njoftimit:** Shtetëror

**Kategoria Mjedisore:** B

**Data e synuar e aprovimit:** 28 Mars 2025

**Statusi:** Aprovuar

**Publikimi i DPP:** 16 Prill 2025

### Përshkrimi i projektit:

Një hua me Garanci Shtetërore deri në 22.5 milionë Euro do t'i vihet në dispozicion Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ("OSHEE", "Klienti", "Kompania"), operatori shtetëror i shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike në Shqipëri. Të ardhurat nga kjo hua do te përdoren për qëllime investimi për të financuar ndërtimin e nënstacionit nëntokësor 110/20 kV në qendër të Tiranës. Vlerësimi fillestari i kostos për nënstacionin, në shumën prej 14.5 milionë eurosh, ishte bazuar në një vlerësim paraprak. Megjithatë, projekti përfundimtar teknik, i zhvilluar nga një konsulent i jashtëm i specializuar, identifikoi një rritje prej rreth 8 milionë euro. Kjo rritje ishte kryesisht rezultat i presioneve inflacioniste mbi çmimet e lëndëve të para, specifikimeve të përmirësuara të projektit, si dhe përfshirjes së kërkeseve teknike përfundimtare.

### Objektivat e projektit:

Projekti do t'i mundësojë OSHEE-së të zëvendësojë një nënstacion të vjetër elektrik me një nënstacion nëntokësor modern dhe inovativ. Ky do të jetë nënstacioni i parë nëntokësor që do të ndertohet në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu, do të jetë nënstacioni i parë i OSHEE-së që funksionon në mënyrë digitale. Digitalizimi i plotë pritet të përmirësojë efikasitetin operacional, cilësinë e furnizimit dhe parametrat e sigurisë dhe shëndetit në punë. Projekti do të nxisë OSHEE-në të përshpejtojë kalimin drejt infrastrukturës digitale dhe të zbatojë programe (përfshirë trajnime) për të mbështetur zbatimin e shpejtë dhe tranzisionin drejt kësaj infrastrukturës digitale.

### Ndikimi në tranzicion:

[ETI 70]

Ndikimi i pritshëm i tranzisionit nga Projekti rrjedh nga cilësitë "E gjelbër" dhe "E integruar". Cilësia "E gjelbër" arrihet përmes uljes së humbjeve teknike në rrjetin elektrik dhe mbrojtjes së nënstacionit nga ngjarjet ekstreme të motit, korrozioni dhe aktet e vandalizmit. Përdorimi i fondeve do të mbështesë një sistem energjistik me nivel të emëtimeve të rrjetit nën 100 gCO<sub>2</sub>e/kWh, falë prodhimit të energjisë pothuajse 100% nga burime hidrike në Shqipëri.

Cilësia “E integruar” arrihet përmes prezantimit të një teknologje inovative që përmirëson cilësinë e infrastrukturës përkatëse. Zëvendësimi i një nënstacioni mbi tokë me një nënstacion nëntokësor synon në mënyrë specifike përmirësimin e besueshmërisë të sistemit dhe fleksibilitetit operacional. Kjo do t’i mundësojë OSHEE-së të arrijë ulje të ndjeshme të humbjeve në transmetim, duke e afruar performancën e saj me praktikat më të mira ndërkombëtare.

#### **Informacion mbi Klientin:**

OSHEE është shoqëri 100% shtetërore, dhe kryen shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike në Shqipëri. OSHEE furnizon të gjithë klientët e rregulluar në tregun vendas si dhe vepron si furnizues i mundësisë së fundit për klientët në tregun e parregulluar. OSHEE është përgjegjëse për rrjetin e shpërndarjes dhe vepron si blerës i energjisë elektrike të prodhuar nga shumica e PPE-ve (Prodhues të Pavarur të Energjisë) në Shqipëri. Furnizuesi kryesor i OSHEE-së është KESH i cili ka një Detyrim të Shërbimit Publik (DPS) për të furnizuar OSHEE-në me sasinë e nevojshme të energjisë për të përbushur kërkosha e rregulluar.

#### **Përbledhje e financimit të BERZH:**

22,500,000.00 Euro

#### **Kosto totale e Projektit:**

22,500,000.00 Euro

#### **Përbledhje Mjedisore dhe Sociale:**

Kategoria B (Politika Mjedisore dhe Sociale 2019). Çështjet mjedisore dhe sociale që lidhen me ndërtimin e një nënstacioni shpërndarës nëntokësor modern 110/20 KV në qendër të Tiranës janë specifike për vendndodhjen dhe mund të vlerësohen dhe adresohen lehtësish. Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) ka nisur së brendshmi përmes pyetësorëve VNMS dhe takimeve me ekipin drejtues tëe klientit, dhe ka vijuar me mbështetjen e një konsulenti të jashtëm, i cili ka kryer një vlerësim mjedisor dhe social të projektit si dhe një shqyrtim të kapaciteteve mjedisore dhe sociale të Klientit për ta zhvilluar projektin në përputhje me kërkosat e performancës të BERZH-it. .

OSHEE është një klient ekzistues i Bankës, përmes një huaje për likuiditet të dhënë për nevoja të kapitalit qarkullues (si pjesë e veprimit të Bankës ndaj Covid-19) në vitin 2021. Plani ekzistues i Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS) është hartuar për të siguruar përputhjen e operacioneve të vazhdueshme të OSHEE-së me Kërkosat e Performancës Mjedisore dhe Sociale të Bankës. Një përbërës kyç i këtij plani është krijimi dhe zbatimi i një sistemi të formalizuar dhe të integruar për menaxhimin e Shëndetit, Sigurisë, Mjedisit dhe Aspektit Social, si dhe emërimi i një menaxheri të lartë për Shëndetin dhe Sigurinë dhe një specialisti mjedisor përgjegjës për aktivitetet operacionale.

Plani konceptual për nënstacionin e ri është shqyrtuar dhe ndikimet për shkak të vendndodhjes pritet të jenë kryesisht të lidhura me menaxhimin e trafikut, zhurmën, ndotjen e ajrit, dridhjet, tokën, sigurinë e jetës dhe nga zjarri, fushën elektromagnetike (EMF), shëndetin dhe sigurinë publike dhe atë profesionale, si dhe menaxhimin nga ana e kontraktorit, të cilat priten të jenë të kufizuara në vendin e

projektit dhe të menaxhueshme përmes praktikave të mira të planifikimit, ndërtimit dhe operimit. Është zhvilluar një studim për zëvendësimin e gazit SF6 dhe nënstacioni i ri do të adoptojë një qasje miqësore ndaj mjedisit me një zgjidhje GIS pa SF6 ose një zgjidhje të përzier me një përzierje minimale të gazeve serrë, për të siguruar një potencial më të ulët të ngrohjes globale, siç është përfshirë në dokumentacionin e tenderit të projektit. Është përgatitur një përbledhje jo-teknike dhe Plani i Angazhimit të Palëve, i cili fokusohet vetëm në ndërtimin dhe operimin e projektit dhe do të dakordohet me Klientin përpara nënshkrimit. Veprimet e tjera që lidhen me menaxhimin e çështjeve mjedisore dhe shoqërore në nivelin e Klientit janë përfshirë në Projektin e Qëndrueshmërisë së OSHEE-së (ID e Projektit 55236).

Mbështetja teknike do të ofrohet për të adresuar çështjet e mbeturat e Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS) që lidhen me Kërkesat e Performancës PR2, PR4 dhe PR10, si dhe për zbatimin e kërkuar të Sistemit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë Mjedisore dhe Sociale si pjesë e Projektit të Qëndrueshmërisë së OSHEE-së. Për më tepër, PVMS do të përfshijë zhvillimin e një kuadri organizativ për procesin e shpronësimit/blerjes së tokës në përputhje me kërkesat kombëtare dhe ato të BERZH-it, duke përfshirë edhe zbatimin për projektin e nënstacionit. BERZH-i do të monitorojë projektin përmes shqyrtimit të raporteve të rregullta mjedisore dhe sociale, si dhe përmes vizitave monitoruese sipas nevojës.

#### **Vlerësimi i përputhshmërisë së projektit me objektivin “e Gjelbër”**

Projekti është në përputhje me masat parandaluese të Marrëveshjes së Parisit, pasi veprimtaria e projektit përfshihet në listën e aktivititeve të pranuara nga Bankat Zhvillimore Shumë Palëshe, nën kategorinë “Transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, duke përfshirë ofrimin e energjisë, ruajtjen e energjisë dhe menaxhimin e kërkesës”. Projekti është në përputhje me objektivat e Marrëveshjes së Parisit, pasi nuk janë identifikuar risqe të dukshme klimatike dhe fizike.

100% e financimit të BERZH-it klasifikohet si financim i gjelbër, pasi mbështet masat e ndërmarra për të arritur objektivat e zbutjes së klimës. Vlerësimi bëhet në përputhje me metodologjinë që përcakton karakteristikat e financimive të gjelbra të investimeve të BERZH-it.

#### **Bashkëpunimi Teknik**

Nuk është e aplikueshme

#### **Vlera e Shtuar :**

Vlerë e shtuar për shkak të strukturës së ofruar të financimit. BERZH ofron terma dhe kushte që nuk disponohen nga burime tregtare, por të nevojshme për financimin e projektit. Për më tepër, mbështetja e BERZH-it do të forcojë kapacitetet operacionale dhe të kapitalit njerëzor të OSHEE-së.

#### **Informacion për Kontaktimin e Shoqërisë**

Enea Karakaci

Enea.Karakaci@oshee.al

[www.oshee.al](http://www.oshee.al)

Blv. Zhan D'Ark, Tiranë, Shqipëri

## Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

## Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë cliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: [projectenquiries@ebrd.com](mailto:projectenquiries@ebrd.com)

Për projektet në sektorin shtetëror, viziton [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: [procurement@ebrd.com](mailto:procurement@ebrd.com)

## Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

## Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtesar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikat e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

## Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombe. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontolleve të integritetit për t'u siguar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korruption dhe shkelje në projektet e finançuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek [compliance@ebrd.com](mailto:compliance@ebrd.com). Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

## Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitonit faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshmëri faqen e BERZH.

Kërkosat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

## Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe çdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitonit faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkësë](#) për rishikim; ose për të

kontaktuar MPPP përmes emailit [ipam@ebrd.com](mailto:ipam@ebrd.com) për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.